



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1854/11 prot.

Datë 21.08.2025

V E N D I M
Nr. 1099/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 21.08.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1009/2025, datë 05/08/2025, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-51753- 06-19-2025, me objekt: “Blerje bateri auto”, me fond limit 1,661,100.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 30-06-2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Albpetrol.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “KAPPA - OIL” SHA me NIPT (J91402501L), me adresë: Zona Kadastrale 2547, Nr.Pasurie 159/182, Vol 19, Fq 219.
- Autoriteti Kontraktor:** Sh.A Albpetrol, me adresë: Albpetrol sh.a, Rr. Fier-Patos, Km. 07.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datën 05.08.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.1009/2025, ku vendosi:

- “1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “KAPPA OIL” SHA, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-51753- 06-19-2025, me objekt: “Blerje bateri auto”, me fond limit 1,661,100.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 30-06-2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Albpetrol.*
 - 2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në përputhje me konstatimet e këtij vendimi, për operatorin ekonomik “KAPPA OIL” SHA.*
 - 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
 - 4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “KAPPA OIL” SHA” Shpk.*
 - 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
 - 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.”*

I.2. Me shkresën nr. 4193/1 prot., datë 11.08.2025, protokolluar me tonën nr. 1854/8 prot., datë 14.08.2025, autoriteti kontraktor Sh.A Albpetrol, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 1009/2025 datë 05.08.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit t “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-51753- 06-19-2025, me objekt: “Blerje bateri auto”, me fond limit 1,661,100.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 30-06-2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Albpetrol.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr. 4193/1 prot., datë 11.08.2025, protokolluar me tonën nr. 1854/8 prot., datë 14.08.2025, autoriteti kontraktor Sh.A Albpetrol, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 1009/2025

datë 05.08.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit t “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-51753- 06-19-2025, me objekt: “Blerje bateri auto”, me fond limit 1,661,100.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 30-06-2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Albpetrol.

II.2. Referuar shkresës së dorëzuar nga autoriteti kontraktor me nr. . 4193/1 prot., datë 11.08.2025, protokolluar me tonën nr. 1854/8 prot., datë 14.08.2025, Sh.A Albpetrol, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 817/2025 datë 27.06.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik, bëri verifikimet përkatëse në sistemin e prokurimeve elektronike të Agjencisë së Prokurimit Publik, lidhur me zbatimin e vendimit Nr. 1009/2025 datë 05.08.2025, nga ku rezultoi, se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e operatorëve ekonomik sipas vendimit Nr. 1009/2025 datë 05.08.2025.

II.3. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, që autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin Nr. 1009/2025 datë 05.08.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik.

Për sa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit te Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor, për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit t “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-51753- 06-19-2025, me objekt: “Blerje bateri auto”, me fond limit 1,661,100.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 30-06-2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Albpetrol.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

